


NEWSLETTER E DIASPORËS



PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#106

QBD/ Përgatiten materialet didaktike për platformën digjitale “Mëso shqip”



Qendra e Botimeve për Diasporën bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Fakultetin Histori Filologji të Universitetit të Tiranës ka përgatitur materialet bazë për hartimin e Platformës Digjitale “Fol shqip” të miratuar me vendim të Këshillit Koordinues të Botimeve për Diasporën, Nr. 160 Prot., datë 16.04.2020 për “Miratimin e krijimit të Platformës online për mësimdhënien e gjuhës shqipe në Diasporë”.

Materialet do të përbëjnë bazën përmbajtësore për ngritjen e platformës për mësimdhënien e gjuhës shqipe në diasporë. Në këtë projekt janë përfshirë legjendat e baladat më përfaqësuese të trashëgimisë sonë popullore si dhe disa nga pjesët më të bukura të letërsisë shqipe e asaj botërore për fëmijë.

Qendra e Botimeve për Diasporën brenda muajit qershor do të vë në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve të gjuhës shqipe materialet e përgatitura, si dhe implementimin e tyre në Platformën Digjitale “Mëso Shqip” përpara nisjes së procesit mësimor për vitin shkollor 2021-2022.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

LIBRAT/ Biblioteka publike e Hantias në Kretë pasuron fondin me libra shqip

Biblioteka e bashkisë së Hantias në Kretë, tashmë do të ketë në dispozicionin e saj, një fond me libra shqip të dhuruar prej shoqatës së emigrantëve shqiptarë që jetojnë atje.

Lajmi bëhet publik në rrjetet sociale prej kësaj biblioteke, ku theksohet se është plotësuar kështu një kërkesë e përhershme e shqiptarëve që jetojnë aty.

“Kjo lëvizje na bën të lumtur, sepse fuqizojmë bashkëpunimin tonë dhe në të njëjtën kohë nxit fëmijët me origjinë shqiptare të vizitojnë Bibliotekat e Fëmijëve, të marrin hua libra dhe të marrin pjesë në programet filantropike kur kushtet e lejojnë atë”, shkruan “Biblioteka Komunale e Hantias”.

Në fondin e dhuruar janë libra për fëmijë, abetare si dhe vepra të shkrimtarëve më të njohur të letrave shqipe.



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



Diaspora Shqiptare

SHKARKO
APLIKACIONIN FALAS

App store: këtu Play store: këtu

Digjitalizimi i Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen



CONNECT
ALBANIA

Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online